



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 359/5 prot.

Tiranë, më 18.9.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 773, datë 7.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 3.9.2024, është njoftuar vendimi nr. 773, datë 7.6.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 773, datë 7.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në datën 15.12.2020, ka shortuar çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Haxhiu, short nga i cili ka rezultuar trupa gjyqese e përbërë nga Komisionerët, znj. Alma Faskaj – Kryesuese, znj. Pamela Qirko – Relatore dhe znj. Xhensila Pine – Anëtare. Vëzhgues ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

3. Për qëllim të procesit të rivlerësimit, sipas nenit Ç, pika 1¹, nenit D, DH dhe E të aneksit të Kushtetutës, Komisioni, bazuar edhe në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuar për këtë subjekt nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*referuar në vijim si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të hartuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*referuar në vijim si AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (*referuar në vijim si KLGJ*).

4. Nga raportet rezulton se:

4.1 **ILDKPKI**, në “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Juljan Haxhiu,” nr. ***/** prot., datë **.10.2018, ka konstatuar:

- (i) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4.2 **AKSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit² mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Juljan *** Haxhiu”.

4.3 **KLKJ**, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe vlerësimit të 5 dokumenteve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit³.

5. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me Raportin dhe Rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 15.5.2024 vendosi: **(i)** Përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Juljan Haxhiu; **(ii)** Njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; **(iii)** Kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 5.6.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Raporti me nr. *** prot., datë **.11.2017, i DSIK-së, deklasifikuar plotësisht me vendim nr.***, datë **.7.2023, të KDZH-së.

³ Raporti me nr. ***/* prot., datë **.9.2022.

i Kongreseve) salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ishte vetë i pranishëm dhe, në përfundim të parashtrimeve, kërkoi konfirmimin në detyrë.

7. Trupi gjykues, bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, krijoi bindjen se:

7.1 Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

7.2 Lidhur me kontrollin e figurës, trupi gjykues, referuar nenit Dh të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, Juljan Haxhiu, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

7.3 Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues, referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, Juljan Haxhiu, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

8. Në përfundim, Komisioni, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

9. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

10. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

11. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

12. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat

kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, si dhe në vlerësim të drejtë të provave.

13. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 773/2024, të Komisionit, dhe i akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

14. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 773, datë 7.6.2024, të Komisionit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III. A - Kontrolli i pasurisë

15. Bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre dhe i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Në respektim të këtij përcaktimi ligjor, vlerësimi i këtij kriteri do të bazohet në analizën juridiko-financiare mbi elementet e deklarimit të pasurisë, mjaftueshmërinë dhe saktësinë, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, të ardhurat, si dhe përmbushja e detyrimeve financiare.

16. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, ka deklaruar për herë të parë në vitin 2003 dhe më pas ka depozituar deklaratat periodike në vijim. Në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, nga shqyrtimi dhe krahasimi i Deklaratës “Vetting” me deklaratat periodike vjetore, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar interesat privatë si vijon:

17. Pasuria e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 89,82 m² dhe “garazh”, me sipërfaqe 18,77 m², ndodhur në rrugën “** ****”, Tiranë**

17.1 Në *D-Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (a) Apartament banimi, ndodhur në Tiranë, rruga “**** ****”, Zona Kadastrale ****, Volumi **, faqe **, me nr. pasurie */****+*_**, me sipërfaqe 89,82 m². Blerë në vitin 2013. *Vlera*: 6.200.000 lekë. *Pjesa takuese*: 50%. *Burimi i krijimit*: (i) 1.312.000 lekë nga kursimet personale; (ii) 4.888.000 lekë, të përfituar nga kredia e marrë pranë ***-së, e cila paguhet me të ardhura nga paga; (b) Garazh për parkim makinash, ndodhur në rrugën “**** ****”, Zona Kadastrale ****, Volumi **, faqe **, me nr. pasurie */****-****, me sipërfaqe 17,77 m². Blerë në vitin 2013. *Vlera*: 500.000 lekë. *Pjesa takuese*: 50%. *Burimi i krijimit*: kursimet familjare.

17.2 Në rubrikën “*Detyrimet Financiare ndaj Personave Juridikë dhe Fizikë*” të *D-Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kredi për blerje apartamenti. Banka **** ****. Shuma: 4.960.000 lekë. Afati i shlyerjes 30 vjet. Kontratë nr. **** rep., nr. **** kol., datë **.9.2013. Interesi 4%. Kësti mujor 25.000 lekë. Kredimarrës së bashku me **** **** (b/shortja).*

17.3 Në *DV-2013*, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar pasuritë objekt vlerësimi, ekzaktësisht si në *D-Vetting*.

17.4 ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.11.2023, konfirmon pasuritë objekt vlerësimi dhe ka depozituar kartelat dhe dokumentacionin e regjistrimit të tyre.

17.5 Këto pasuri janë përfituar nëpërmjet kontratave të shitblerjeve të nënshkruara midis subjektit të rivlerësimit (në cilësinë e palës blerëse) dhe shoqërisë “****” sh.p.k. (në cilësinë e palës shitëse), në datën **.4.2013, respektivisht për: (i) “apartament” me sipërfaqe 89,92 m², me nr. pasurie */*** + *-*, rruga “**** **”, Tiranë, përkundrejt çmimit prej 6.200.000 lekë, ku sipas kontratës blerësi ka paguar jashtë zyrës noteriale shumën prej 1.000.000 lekë, ndërsa shuma prej 5.000.000 lekë do ta paguhet pas lëvrimit të kontratës së kredisë me Bankën *** ***,⁴ dhe (ii) “garazh”, me sipërfaqe 18,77 m², me nr. pasurie */*** – ***, rruga “**** **”, Tiranë⁵, përkundrejt çmimit prej 500.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.

17.6 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Duke filluar nga muaji maj 2007, kam banuar së bashku me bashkëshorten (në atë kohë bashkëjetuese) dhe më pas me fëmijët, në apartamentin e porositur prej babait tim dhe pastaj të blerë prej meje, në adresën Blvd. ***. ***, ndërtesa ***, Tiranë”*.

17.7 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se apartamenti me sip. 89,82 m², ndodhur në rr. “**** **”, Tiranë, blerë në datën **.4.2013, nga “****” sh.p.k. është i njëjtë me apartamentin me sip. 96,5 m² (ku përfshiheshin edhe ambientet e përbashkëta), porositur nga babai i tij, *** **, në vitin 2005, nga i cili ka hequr dorë, duke zgjidhur kontratën në datën **.1.2013.

17.8 Në vijim të pyetësorit, në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka deklaruar se:

- Kontrata e porosisë së babait, në vitin 2005, e ka origjinën te kontrata e sipërmarrjes e datës **.7.2004,⁶ që babai i subjektit ka nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k., nëpërmjet së cilës ka porositur një apartament banimi me sipërfaqe 90 m,² në objektin që do ndërtonte kjo shoqëri, pranë shkollës “**** **”, Tiranë, për çmimin 45.000 euro⁷, prej të cilit është paguar shuma prej 26.500 euro. Për pagesën prej 26.500 euro nuk disponohet faturë apo mandatpagesë, ndërsa burimi i kësaj shumë ishte: (i) 1.500.000 lekë nga vlera e shitjes së apartamentit në Krujë (kontrata nr. ***/**, datë **.6.2001); (ii) 1.900.000 lekë, nga kursime të tjera familjare.

- Kontrata e vitit 2004 ishte pa objekt të përcaktuar qartë, sepse ishte lidhur përpara se shoqëria të merrte lejen e ndërtimit, bazuar edhe në marrëdhënien personale dhe profesionale midis babait të subjektit dhe ortakut të “****” sh.p.k., si dhe nevojës së ngutshme të këtij të fundit për likuiditete. Kështu që me marrjen e lejes së ndërtimit, babai i subjektit e formalizoi marrëveshjen me kontratën e porosisë të datës **.2.2005, me objekt blerjen e një apartamenti me sip. 96,5 m² dhe një garazhi, përkundrejt çmimit prej 58.250 euro.

- Në vitin 2006, me afrimin e përfundimit të karabinasë, për pagesën e kështit të dytë prej 20.000 euro, u mor kredia prej 1.900.000 lekë (15.535 euro), me kontratën e kredisë nr. ***

⁴ Kontratë shitblerje me rezervë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.4.2013.

⁵ Kontrata e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.4.2013.

⁶ Kontratë sipërmarrjeje për ndërtim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.7.2004.

⁷ Në kontratë është parashikuar se: (i) shuma prej 26.500 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale, para lidhjes së kontratës; (ii) pjesa tjetër, 18.500 euro do të likuidohet me mbarimin e pallatit.

rep., nr. *** kol., datë **.6.2006⁸, ku subjekti i rivlerësimit ishte në cilësinë e kredimarrësit dhe babai i tij në cilësinë e dorëzanesit. Ndërsa shuma prej 4.465 euro, me burim nga kursimet familjare, është paguar në një datë të mëvonshme, për të cilën nuk disponohet faturë.

- Meqenëse deri në fund të vitit 2012, apartamenti nuk ishte regjistruar në regjistrat kadastralë, kontrata e shitjes nuk ishte lidhur, pagesa e këstit të fundit nuk ishte kryer dhe, me qëllim shlyerjen e një kredie me interesa të larta të marrë nga subjekti, bashkëshortja dhe babai i tij⁹, në vitin 2010, me qëllim blerjen e një apartamenti nga motra e subjektit, babai i subjektit negocioi për revokimin e kontratës së porosisë dhe kthimin e shumës së paguar. Sipërmarrësi mundi t'i kthente shumën prej 5.200.000 lekë dhe pjesa e mbetur (640.000 lekë) u llogarit si kredit në blerjen e apartamentit nga ana e subjektit.

17.9 Në përfundim të hetimit administrativ paraprak, bazuar në analizën financiare të kryer, Komisioni ka konstatuar se familja Haxhiu ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën **.7.2004, për shlyerjen e këstit të parë për porositjen e apartamentit të shoqëria “****” sh.p.k., si dhe për të justifikuar plotësisht pagesën e bërë gjatë vitit 2006, për shlyerjen e këstit të dytë, për porositjen e apartamentit dhe garazhit nga shoqëria “****” sh.p.k.

17.10 Nga aktet në dosje, rezulton se për këto pasuri janë kryer transaksionet e mëposhtme: (a) Në datën **.1.2013, subjekti i rivlerësimit (në cilësinë e palës blerëse) dhe shoqëria “****” sh.p.k. (në cilësinë e palës shitëse) kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes me rezervë (pasuri e paluajtshme),¹⁰ me objekt pasuritë e paluajtshme të llojit: (i) “apartament”, me sipërfaqe 89,92 m², me nr. pasurie */*** + * – *, ZK ***, Rr. “**** **”, Tiranë; dhe (ii) “garazh”, me sipërfaqe 18,77 m², me nr. pasurie */*** – ***, ZK ***, Rr. “**** **”, Tiranë, për çmimin total prej 6.000.000 lekë; (b) Në datën **.4.2013 është nënshkruar dokumenti “Revokim i kontratës së shitblerjes me rezervë me nr. *** rep., nr. *** kol.”; (c) Në datën **.4.2013, është nënshkruar Kontrata e shitblerjes me rezervë (pasuri e paluajtshme) me nr. *** rep., nr. *** kol., me objekt shitblerjen e apartamentit me sip.89,82 m², përkundrejt çmimit prej 6.200.000 lekë, ku përcaktohet se shuma prej 1.200.000 lekë është paguar jashtë zyrës noteriale dhe pjesa tjetër prej 5.000.000 lekë do të paguhet pas lëvrimit të kontratës së kredisë me Bankën **** ** (***); (d) Në datën **.4.2013, është nënshkruar Kontrata e shitblerjes me rezervë (pasuri e paluajtshme) me nr. *** rep., nr. *** kol., me objekt shitblerjen e një garazhi për parkim makinash, përkundrejt çmimit prej 500.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.

17.11 Në lidhje me kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit pranë ***-së, kjo e fundit¹¹ konfirmon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në datën **.9.2013, kanë nënshkruar një kontratë kredie bankare³⁸ me këtë bankë, për përfitimin e shumës prej 4.960.000 lekë. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka aplikuar dhe përfituar këtë kredi me kushte lehtësuese, bazuar në VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, të ndryshuar.

⁸ Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit në *** Bank (ish *** Bank), konfirmohet se, në datën **.7.2006, disbursohet kredia në shumën prej 1.900.000 lekë dhe se, po në të njëjtën datë, këto fonde transferohen te “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim nga Juljan Haxhiu dhe ***. ***. Pagesë e këstit të fundit për blerje apartamenti sipas kontratës së porosisë (ekuivalenti 15.535 euro).

⁹ Kontratë huaje me *** Bank, datë **.6.2010.

¹⁰ Kontratë shitblerje me rezervë me nr. *** rep., nr. ** kol., datë **.1.2013.

¹¹ Shkresat e ***: (i) nr. ***/* prot., datë **.2.2021; (ii) nr. ***/* prot., datë **.2.2023.

17.12 Komisioni konstaton se shuma prej 4.960.000 lekë është disbursuar në llogarinë e subjektit në ***, në datën **.10.2013, dhe në datën **.10.2013, vlera prej 4.888.000 lekë – pjesë e këtyre fondeve është transferuar me përshkrimin: *“Juljan Haxhiu kalim shumë kësti i fundit për blerje apartamenti në favor të *** sh.p.k. sipas kontratës së shitblerjes me rezervë me nr. *** rep., nr. ** kol., datë **.4.2013”*.

17.13 Për sa më sipër, Komisioni ka arsyetuar se në tërësi transaksionet e kryera nga subjekti në lidhje me dy pasuritë objekt vlerësimi janë kryer me qëllim përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese në ***. Kështu, duket se në kushtet kur kishte aplikuar për kredi të butë subjekti ka revokuar kontratën e parë të shitjes me rezervë të nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k., pasi këto lloj kredish nuk financojnë blerjen e posteve të parkimit (garazheve), por janë të destinuara vetëm për qëllimi strehimi. Në këto rrethana, duket se subjekti ka revokuar kontratën e shitblerjes me rezervë, të datës **.1.2013, dhe ka bërë dy kontrata më vete për apartamentin dhe garazhin, në datën **.4.2013. Kontrata e shitblerjes me rezervë të apartamentit, e datës **.4.2013, është pjesë e dosjes së kredisë dhe, mbi bazën e çmimit të përcaktuar në këtë kontratë, duket se është disbursuar vlera e kredisë në favor të subjektit (supozohet 80% e çmimit total të apartamentit – sipas politikave të njohura të kohës të bankave tregtare që operojnë në Republikën e Shqipërisë).

17.14 Gjithashtu, duket se qëllimi final i marrjes së kësaj kredie ka qenë shlyerja e kredisë së marrë më parë nga subjekti, bashkëshortja dhe babai i tij, për financimin e blerjes së apartamentit të blerë nga e motra, ***, ***. Subjekti kishte rreth gjashtë vjet që e përdorte apartamentin e porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., në të cilën duket se ishte kryer pjesa më e madhe e pagesës totale për shlyerjen e dy kësteve të para (paguar rreth 80 % e totalit të çmimit të përcaktuar në vitin 2005). Në këtë kuptim, duket se kontratat e lidhura nga subjekti me shoqërinë “****” sh.p.k., në vitin 2013, janë në vazhden e marrëdhënies së krijuar me këtë shoqëri që në vitin 2005.

17.15 Në përfundim, Komisioni konstaton se duket se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime dhe transaksione fiktive – duke vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, me qëllim përmbushjen e kushteve për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese.

17.16 Gjithashtu, Komisioni kreu analizën financiare me qëllim evidentimin e mundësisë së familjes së subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e çmimit të plotë të vlerësuar për pagesën e kryer në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., për porositjen e pasurive të llojit “apartament banimi” dhe “garazh”, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së dy pasurive objekt vlerësimi (apartamentit dhe garazhit), shtesat e likuiditeteve në *cash* dhe në llogari bankare, si dhe mbulimin/kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2013. Evidentohet balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 1.3 milionë lekë.

17.17 Me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi konstatimet e mësipërme. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur se veprimet e kryera nuk kanë qenë fiktive, nuk kanë pasur si qëllim përmbushjen e kushteve për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese dhe nuk cenojnë rregullat e etikës, duke argumentuar se asnjë

nga veprimet e tij nuk është kryer pa qëllim për të sjellë pasoja juridike, madje kanë sjellë plotësisht e vazhdojnë të sjellin edhe sot pasoja juridike.

17.18 Në lidhje me rrethanën e konstatuar nga Komisioni se, në periudhë të afërt me aplikimin për kredi me kushte lehtësuese, e më konkretisht në datën **.1.2012, bashkëshortja ***. ***, i ka dhuruar babait të saj banesën që ajo kishte në pronësi, apartamentin me sipërfaqe prej 91 m,² të ndodhur në Tiranë, subjekti shpjegon se, për nga shkaku ligjor dhe përmbajtja, ky transaksion nuk është bërë për të plotësuar kushtet për kredi lehtësuese, pasi argumenton se ato kushte plotësoheshin thelbësisht, edhe nëse apartamenti nuk do të ishte dhuruar.

17.19 Në të njëjtën linjë arsyetimi me sa më sipër, subjekti referon se apartamenti i blerë nga familja e tij (në emër të babait ***. ***), porositja dhe pagesa e pjeshme e të cilit është analizuar hollësisht nga Komisioni, nuk mund të përbëjnë mosplotësim të kushteve të VKM-së nr. 600. Veprimet paralele të babait të tij për marrjen e likuiditeteve dhe shlyerjen e kredisë së marrë bashkërisht janë vetëm rastësisht të lidhura me veprimet e tij dhe se mes tyre nuk ka mbivendosje të qëndrimit intelektual, prandaj nuk duhen parë të lidhura për nga qëllimi i tyre, duke parashtruar se marrëveshja dhe veprimet mes babait dhe shtetasit ***. ***. kanë qenë një çështje e tyre, në të cilën deklaroi se nuk është përfshirë.

17.20 Në lidhje me rezultatin financiar të vitit 2013, vit në të cilin janë blerë nga subjekti dy pasuritë objekt vlerësimi, subjekti, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar përfshirjen e disa të ardhurave shtesë të përfituara nga leja e lindjes së bashkëshortes, të ardhurat e përfituara prej tij si rezultat i shërbimeve të kryera për OSBE-në, heqjen e shpenzimeve mjekësore të vetëdeklaruar prej tij për vitin 2013¹², pasi janë mbuluar nga kompanitë e sigurimit, si dhe kërkon reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, duke pretenduar se një pjesë e tyre janë mbuluar nga punëdhënësit/organizatorët.

17.21 Në përfundim, Komisioni, pasi vlerësoi dhe analizoi dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e subjekti i rivlerësimit, konkludoi se, në momentin e aplikimit, subjekti i rivlerësimit plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret për t'u trajtuar me kredi me kushte lehtësuese sipas VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë".

17.22 Gjithashtu, Komisioni çmoi se veprimet juridike të kryera nga subjekti, pavarësisht kompleksitetit të tyre, nuk mund të vlerësohen si veprime fiktive apo të simuluar. Nga analizimi në tërësi i të gjitha veprimeve të kryera nga subjekti dhe babai i tij, megjithëse ato paraqiten mjaft komplekse, Komisioni e gjen bindës shpjegimin e subjektit se, nëse analizohen si dy veprime të ndara, me qëllime të ndryshme, secili paraqitet si një veprim i vërtetë juridik, që ka sjellë pasojën ligjore të synuar nga palët. Të gjitha veprimet e mësipërme të palëve janë kryer në kuadrin e marrëdhënieve të posaçme familjare, me qëllim përmbushjen e nevojës për strehim të anëtarëve të familjes së origjinës së subjektit, përfshirë edhe vetë subjektin.

17.23 Sa i përket analizës financiare të vitit 2013, Komisioni rishikoi analizën financiare, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme në vlerën - 744.731 lekë, për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së dy pasurive objekt vlerësimi (apartament dhe garazh), shtesat e likuiditeteve në *cash* dhe në llogari bankare, si dhe mbulimin/kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruar e të

¹² Vetëdeklaruar gjatë hetimit administrativ.

evidentuara për vitin 2013, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, por në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit¹³, Komisioni konkludoi se kjo balancë negative fondesh nuk është e tillë për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

17.24 *Komisioneri Publik*, përveç sa më sipër, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, në lidhje me analizimin e veprimeve juridike të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, në drejtim të përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese për blerjen e apartamentit, pasi, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, nga analizimi i akteve në dosje, *Komisioneri Publik* vëren se:

17.24.1 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në datën **.9.2013, kanë nënshkruar kontratë kredie me ***-në, për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, në vlerën 4.960.000 lekë, për financimin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 96,5 m², ndodhur në Tiranë.

17.24.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi me kushte lehtësuese, bazuar në VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, të ndryshuar, akt nënligjor, i cili parashikoi gjyqtarët e shkallës së parë si subjekte përfituese me VKM-në e ndryshuar nr. 1714, datë 29.12.2008. Sipas këtyre ndryshimeve të fundit, subjekteve përfituese gjatë kohës së ushtrimit të detyrës, nëse kishin nevojë për strehim, u lindte e drejta të kërkonin trajtim me kredi me kushte lehtësuese nga shteti për blerje banese në vendin e ushtrimit të detyrës.

17.24.3 VKM-ja nr. 600/2007 parashikonte si kushte thelbësore në dhënien e mundësisë për të përfituar nga programet e strehimit, mungesën e pasjes në pronësi të pasurive të paluajtshme për strehim apo, përgjithësisht, mundësi të tjera financiare në formë aktiviteti ekonomik, likuiditete dhe mënyrë jetese, që dëshmon për gjendje financiare të konsiderueshme ose që tejkalon kufirin e kredisë në emrin e funksionarit apo të personave të lidhur me të.

17.24.4 Nga aktet në dosje rezulton se, kur subjekti i rivlerësimit filloi procedurat e aplikimit për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, ai dhe personat e tjerë të lidhur kishin në pronësi dhe përdorim, pasuri, pasja e të cilave përbënte kusht skualifikues për përfitimin e një kredie me kushte lehtësuese, sipas germës “ç”, të pikës 6, të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007¹⁴, konkretisht:

*i) Apartament në pronësi të prindërve, ndodhur në bulevardin “*** **”, me sipërfaqe 133 m², pronësia mbi të cilin ishte fituar në vitin 2000 nga babai i tij;*

*ii) Apartament banimi me sipërfaqe 90 m,² pranë shkollës “*** **”, Tiranë, për të cilin ishte paguar pjesa më e madhe e çmimit prej 45.000 euro. Subjekti, në vitin 2006, lidhur me këtë apartament, kishte nënshkruar kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2006, me vlerë 1.900.000 lekë, me qëllim “blerje apartamenti”, apartament tek i cili subjekti kishte të drejta reale pasurore, prej kur kishte filluar të banonte, sipas deklaramit duke filluar nga viti 2007;*

¹³ Referohuni qëndrimin të mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 38/2021 (JR).

¹⁴ ç) Nuk kanë në pronësi të tyre apo bashkëshortit/es pasuri të luajtshme, mjete motorike për qarkullim në tokë/det/ajër, likuiditete, tituj pronësie, përfshi edhe të drejta reale pasurore, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim.

iii) Apartament banimi, me sipërfaqe 91 m², regjistruar në emër të bashkëshortes, në vlerën 4.500.000 lekë, i ndodhur në Rrugën e ***, blerë me kontratën e shitblerjes datë **1.2004¹⁵;

iv) Apartament banimi në pronësi të babait, ndodhur në Durrës, Lagjja **, ***, me sipërfaqe 53 m², në vlerën 34.800 euro, për të cilin subjekti i rivlerësimit kishte nënshkruar kontratën e kredisë për financimin e tij në një bankë të nivelit të dytë, në vitin 2009¹⁶.

17.24.5 Në vijim, për sa subjekti nuk përmbushte kushtet për përfitimin e kësaj kredie, vlerësohet se mbyllja e marrëdhënieve të mëparshme të kreditimit të marra prej subjektit për financimin e apartamenteve dhe dhurimi nga bashkëshortja e subjektit i apartamentit që ajo kishte në pronësi, babait të saj, u kryen vetëm për plotësimin e kushteve formale për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese nga ana e subjektit të rivlerësimit.

17.24.6 Sa i takon nënshkrimin të dokumentacionit ligjor nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me apartamentin në rrugën “*** **”, nga hetimi, rezultoi se në vitin 2005, babai i subjektit kishte nënshkruar kontratë porosie me shoqërinë “****” sh.p.k., nëpërmjet së cilës kishte porositur pasurinë e llojit *apartament banimi + garazh*, për çmimin total 58.250 euro. Subjekti ka konfirmuar se 26.500 euro janë paguar para lidhjes së saj dhe 15.535 euro me marrjen e kredisë bankare nga subjekti i rivlerësimit, në vitin 2006.

17.24.7 Në datën **1.2013, babai i subjektit, ***, ***, dhe shoqëria “****” sh.p.k. vendosën të zgjidhin kontratën e porosisë së datës **2.2005. Një ditë më vonë, në datën **1.2013, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “****” sh.p.k. nënshkruan kontratën e shitblerjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., me objekt të njëjtën pasuri, “apartament” në rrugën “*** **”, Tiranë dhe “garazh”, për çmimin total prej 6.000.000 lekë. Në datën **4.2013, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “****” sh.p.k. revokuan këtë kontratë shitblerje.

17.24.8 Në datën **4.2013, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “**” sh.p.k. nënshkruan kontratën e shitblerjes me rezervë, me objekt të njëjtën pasuri, “apartament”, me adresë rruga “*** **”, Tiranë, për çmimin 6.200.000 lekë, si dhe kontratën e shitblerjes, me objekt pasurinë e llojit “garazh”, me sipërfaqe 18,77 m², për çmimin 500.000 lekë.

17.24.9 Transaksionet e sipërcituara të kryera nga subjekti, në vitin 2013, konfirmojnë jo vetëm faktin e posedimit të pandërprerë të kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit që nga viti 2007, por dhe fiktivitetin e veprimeve ligjore të kryera mes palëve, pasi ato rezultojnë se janë kryer vetëm për t’iu paraqitur bankës në funksion të përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese dhe jo qëllimit të vetë palëve.

17.25 Në këtë drejtim, *Komisioneri Publik* vlerëson se, në përputhje me qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që, ndër të tjera, është rikthimi i besimit

¹⁵ Komisioni ka konstatuar se në periudhë të afërt me aplikimin për kredi me kushte lehtësuese, e më konkretisht, në datën **1.2012, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. *** ***, i ka dhuruar babait të saj banesën që ajo kishte në pronësi, apartamentin me sipërfaqe prej 91 m², të ndodhur në Tiranë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se kjo pasuri ishte blerë nga personi i lidhur rreth 3 vjet e 6 muaj para fillimit të bashkëjetesës (sipas deklaramentit) dhe rreth 4 vjet e 10 muaj para lidhjes së martesës ligjore.

¹⁶ Në D-Vetting, subjekti deklaroi: Pasuri të llojit apartament banimi, ndodhur në Durrës, lagjja **, ***, me sipërfaqe prej 53 m², me vlerë 34.800 euro. Zotëron 25% pjesë takuese të kësaj pasurie. Burim krijimi: (i) 13.800 euro, nga kursimet personale të prindërve të tij *** dhe ***. **.; (ii) 5.000 euro, nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes ***. **.; (iii) 2.000.000 lekë (ose 16.000 euro), të përfituar nga kredia e marrë në *** Bank. Subjekti ka deklaruar se ky apartament është blerë në vitin 2009 dhe është regjistruar në emër të babait ***. ***, por ai vetë dhe bashkëshortja kanë kontribuar në pagesën e kësaj të parë dhe në vlerën e kredisë së marrë, të cilën e kanë paguar me të ardhurat nga pagat.

të publikut te sistemi i drejtësisë, veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, për qëllim përfitimin financiar, janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një gjyqtar, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia, bazuar në parashikimet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

18. Pasuria e llojit “tokë arë”, e familjes së personit të lidhur

18.1 Nga hetimi administrativ, gjatë korrespondencës së Komisionit me noterin publik ***, ***, u administrua një “Prokurë e posaçme”, datë **.5.2014¹⁷, nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit, nëna dhe vëllai i saj, të cilët emërojnë si përfaqësues ligjor të posaçëm, z. ***, ***. (babain e bashkëshortes së subjektit), që të kryejë të gjitha veprimet juridike, administrative dhe ligjore në lidhje me pasurinë e paluajtshme “tokë arë”, pasuri e familjes bujqësore, regjistruar në ZVRPP-në Gjirokastrë, ZK ***, vol. *, fq.***, nr. pasurie ***/**, në fshatin ***, Gjirokastrë, me sipërfaqe 6.800 m², regjistruar në emër të shtetasit ***. ***. ***.

18.2 Nuk rezulton që kjo pasuri të jetë deklaruar në *D-Vetting* nga bashkëshortja e subjektit, as në për vitet 2003 dhe 2004, në cilësinë e subjektit deklarues në ILDKPKI, si dhe nuk është deklaruar as prej vitit 2008 e në vijim, në cilësinë e personit të lidhur.

18.3 Për këtë fakt, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, duke i kërkuar të deklarojë për periudhën dhe mënyrën e fitimit të kësaj pasurie nga personi i lidhur dhe familjarët e saj, si dhe të specifikojë burimin konkret të krijimit të saj, si dhe të evidentojë nëse ka pasur investime të kryera mbi të, vlerën e investimit, burimin e krijimit, si dhe të deklarojë statusin aktual të kësaj pasurie, pjesën takuese dhe të drejtat reale që disponon lidhur me të.

18.4 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se pasuria e paluajtshme e llojit “tokë arë”, regjistruar në ZVRPP Gjirokastrë, me sipërfaqe 6.800 m², është fituar nga babai i bashkëshortes ***. ***, në bazë të ligjit nr. 7501, si ish-punonjës i një ndërmarrjeje bujqësore.

18.5 Subjekti ka deklaruar se kjo tokë është fituar midis viteve 1993 – 1995 dhe se, në dijeninë e tyre, kjo pasuri nuk është përdorur asnjëherë nga babai i bashkëshortes e as nga persona të tjerë, duke evidentuar se një ndër arsyet është edhe fakti se familja e bashkëshortes nuk ishte familje bujqësore në kuptimin literal të kësaj fjale, pasi ata jetonin në qytet dhe nuk kryenin aktivitet bujqësor.

18.6 Në vijim, subjekti ka evidentuar se, sipas dokumentacionit të mbajtur nga familja e bashkëshortes, kjo pasuri është regjistruar në regjistrat kadastralë në vitin 2011 dhe, se në këtë kohë, bashkëshortja tij kishte disa vite që ishte ndarë nga trangu familjar, prandaj ajo nuk ka pasur as dijeni për këtë fakt dhe as nuk e ka konsideruar veten bashkëpronare, në kushtet që nuk ishte më pjesë e familjes.

18.7 Në vlerësim përfundimtar, Komisioni çmon se rezulton e provuar se familja e bashkëshortes së subjektit, për periudhën 1976 – 2005, ka qenë e regjistruar si banuese në qytetin e Gjirokastrës, e për rrjedhojë, nuk mund të trajtohej me tokë si familje bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën”. Nga ana tjetër, rezulton se babai i bashkëshortes së subjektit, z. ***. ***, figuron të ketë qenë i punësuar si agronom për periudhën 1967 – 1992.

¹⁷ Përcjellë me shkresën e datës **.3.2022.

18.8 Rezulton se, në vitin 2014, kjo pasuri është shitur nga babai i subjektit, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore – sipas prokurës së dhënë nga bashkëshortja dhe fëmijët e tij, ku përfshihej edhe personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vlerën prej 1.944.000 lekë.

18.9 Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar se, në kushtet kur duket se kemi të bëjmë me një pasuri të fituar me ligj, pra se nuk ka dyshime për krijimin e saj, si dhe se personi i lidhur nuk ka deklaruar dhe as pretenduar të ardhura si pjesë takuese nga shitja e saj, mungesa e supozuar e deklarimit të pjesës takuese mbi të nga personi i lidhur në deklaratat e interesave private periodikë vjetorë, të depozituara prej saj ndër vite në ILDKPKI, nuk ndikon në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj bashkëshortit të saj, gjyqtarit Juljan Haxhiu.

18.10 *Komisioneri Publik*, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, lidhur me mosdeklarimin e pasurisë nga ana e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në bashkëpronësi me familjarët e saj të origjinës, e cila është fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar saktësisht të gjitha interesat pasurorë në deklaratat periodike vjetore dhe në Deklaratën *Vetting*, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016.

18.11 *Komisioneri Publik* vlerëson se kjo pasaktësi duhet vlerësuar nga Kolegji në vlerësimin tërësor të rrethanave faktike dhe ligjore të konstatuara gjatë hetimit administrativ në Komision, për qëllim të procesit të rivlerësimit.

19. Në përfundim, *Komisioneri Publik*, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me problematikat e veprimeve të subjektit, me qëllimin përfitimin e kredisë tregtare, çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, vendimi nr. 773, datë 7.6.2024, i Komisionit, duhet ndryshuar, pasi nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

IV. Kërkimi i ankimit

20. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, *Komisioneri Publik* ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016;

21. Duke ritheksuar se *Komisioneri Publik* ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

22. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, *Komisioneri Publik* ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

- 23.** Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016;
- 24.** Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:
- Ndryshimin e vendimit nr. 773, datë 7.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO